



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr. 310/2 prot.,

Datë 15.02.2023

**FORMULAR PËR PUBLIKIM  
LIDHUR ME PRETENDIMET MBI KUALIFIKIMIN/SKUALIFIKIMIN E  
OFERTUESVE TË TJERË DUKE REFERUAR VETËM KRITERET PËR TË CILAT  
NGRIHEN PRETENDIME**

- Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Ervin Luzi” PF në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar”, me Nr. REF-56346-01-19-2023, me objekt: “Materiale Pastrimi dhe Dezinfektimi”, me fond limit 3.750.000 lekë pa TVSH, zhvilluar nga autoriteti kontraktor, Ndërmarrja e Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Çerdhes, Korçë.
- Ankimues:** “ANBIM” SHPK  
Adresa: Rruga “Muhamet Gjollesha”, Pall 30, Tiranë.
- Autoriteti Kontraktor:** Ndërmarrja e Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Çerdhes.  
Adresa: Dhimitrer Denasi, Korçë.
- Persona të Interesuar:** “Ervin Luzi” PF  
Adresa: Lagjja “Katund i Ri”, Rruga “Ali Pashë Gucia” Godina nr.5, Yrshek, Kashar, Tiranë.

Në datën 14.02.2023 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është protokolluar ankesa me nr. 310 prot., e operatorit ekonomik “ANBIM” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar”, me Nr. REF-56346-01-19-2023, me objekt: “Materiale Pastrimi dhe Dezinfektimi”, me fond limit 3.750.000 lekë pa TVSH, zhvilluar nga autoriteti kontraktor, Ndërmarrja e Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Çerdhes, Korçë.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Ervin Luzi” PF.

Bazuar në nenin 112 pika 4 gërma “c” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: “Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon: a) ankesën e plotë në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit; b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar; c) pretendimet mbi kualifikimin/skualifikimin e ofertuesve të tjerë duke referuar vetëm kriteret për të cilat ngrihen pretendime.”.

Komisioni i Prokurimit Publik publikon kriteret për të cilat operatori ekonomik “ANBIM” SHPK, në ankesën me nr. 310 prot., datë 1402.2023, pretendon se nuk përmbushen nga operatori ekonomik “Ervin Luzi” PF pjesëmarrës në procedurën e prokurimit.

Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime për mospërmbushje nga ana e operatorit ekonomik “Ervin Luzi” PF të kriterëve si më poshtë vijon:

[...]

- **KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

**2.3. Kapaciteti teknik:**

2.4 Operatori ekonomik duhet të paraqesë mostra të mallit ditën dhe orën e hapjes së tenderit, sepse Autoriteti Kontraktor e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Mostrat do të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe do të jenë në kontroll të autoritetit kontraktor. Ato i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, 30 (tridhjetë) ditë pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit.(karakteristikat e mostrave sipas specifikimeve teknike).

Lista e produkteve të mostrave mbi bazën e së cilës O/E duhet të dorëzojnë në diën dhe orën e caktuar në DST;

<b>Nr</b>	<b>Emërtimi I mallit</b>
1.	Fshesa Plastike (Furca)+shkop
2.	Shkopinj per shtupat e pastrimit
3.	Solucion per larjen e duarve (leng)
4.	Pluhur lares dore

5.	<i>Dezinfektant banje(klor leng)</i>
6.	<i>Solucion per xhamat</i>
7.	<i>Solucion per pllakat(arome)</i>
8.	<i>Doreza pune plastike</i>
9.	<i>Shtupa pastrimi</i>
10.	<i>Kova pastrimi</i>
11.	<i>Kosha mbeturinash te medha</i>
12.	<i>Kosha mbeturinas te vegjel</i>
13.	<i>Pastrues wc (xhel)</i>
14.	<i>Solucion per enet</i>
15.	<i>Alkol (1 liter) 90%</i>
16.	<i>Dezinfektant duarsh (500)ml</i>
17.	<i>Piceta Pastrimi</i>
18.	<i>Tela per pastrimin e eneve</i>
19.	<i>Kartopiceta buzesh</i>
20.	<i>Leter Higjenike</i>
21.	<i>Mbulesa leter tavoline</i>

- *Mosparaqitja e mostrave te mallit ditën dhe orën e percaktuar per zhvillimin e tenderit perben shkak per skualifikim. [...]*

Publikuar në rregjistrin e ankesave më datë 15.02.2023.

### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Anëtar**  
**Anila Malaj**

**Anëtar**  
**Kreshnik Ternova**

**Nënkryetar**  
**Fiorent Zguro**